

# **STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TË SHLP TBU 2012-2017**

**Përditësime dhe ndryshime të strategjisë për  
tre vitet akademike:**

**2014-2015; 2015-2016; 2016-2017**

**dhe plani buxhetor trevjeçar përkatës**

**Miratuar me vendim të Bordit Drejtues sipas propozimit të Senatit  
Akademik**

**15 Nëntor 2014**

## **PËRMBAJTJA**

<b>1. ARSYET E NDRYSHIMIT TË STRATEGJISË .....</b>	<b>3</b>
<b>2. ZBATIMI I DERISOTËM I STRATEGJISË .....</b>	<b>4</b>
<b>3. VIJIMI DHE NDRYSHIMET .....</b>	<b>5</b>
<b>4. PLANI BUXHETOR 3 VJEÇAR DHE FINANCIMI .....</b>	<b>8</b>

## 1. ARSYET E NDRYSHIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia e TBU u hartua brenda vitit të parë akademik për periudhën 6 vjeçare akademike tetor 2011 - shtator 2017. Mbi këtë bazë: u realizua ngritja e të gjitha strukturave organizative; u zhvillua procesi mësimor kombinuar me aftësimin në praktikë të studentëve; u krye me sukses procesi i akreditimit institucional dhe i të gjitha programeve në shkurt-gusht 2013; u krye me sukses diplomimi i brezit të parë të studentëve Bachelor dhe Master të TBU në përfundim të vitit akademik tetor 2012-shtator 2013.

Viti akademik tetor 2013-shtator 2014 ishte një tjetër moment sfide për TBU e cila kaloi me sukses inspektimet ligjore të autoriteteve shtetërore në periudhën shkurt - korrik 2014, kryer në të gjitha shkollat e larta. Nga ky proces TBU u klasifikua si shkollë korrekte e cilësore që respekton legjislacionin në fuqi, ndryshe nga disa shkolla të tjera të larta, private por edhe degë të shkollave publike të cilat, për shkaqe të parregullsive ligjore dhe/ose mungesës së kapaciteteve, u mbyllën nga këto autoritete ose iu pezullua aktiviteti.

Në tetor 2014, pas disa konsultimeve intensive, paraprirë edhe nga njohje dhe bashkëpunime të mëparshme, Grupi Balfin ([www.balfin.al](http://www.balfin.al)) u bë aksioner me 30% të kuotave në TBU sh.p.k. Qëllimi i kësaj përfshirjeje ishte, nga njëra anë forcimi i bashkëpunimit të TBU me botën e biznesit dhe nga ana tjetër vetë ky grup e konsideron TBU si një mundësi për rritjen e kapaciteteve menaxheriale të stafit të grupit.

Përfshirja e grupit Balfin, grupi më i madh i biznesit në Shqipëri, me mbi 3000 punonjës dhe xhiro vjetore, për vitin fiskal 2013, afro 300 milion euro, i jep mundësi TBU-së të zhvillojë finalizojë fazën e vet investuese 6 vjeçare, të nisur në vitin 2010, deri në arritjen e pikës së vetëmjaftueshmërisë financiare. Ky proces do të realizohet sipas një skenari të rritjes graduale të numrit të studentëve deri tek numri i synuar, pa nxitim dhe pa stres, e duke ruajtur e forcuar parametrat e cilësisë.

Tre vitet e para të zbatimit të strategjisë dhe katër të parat që nga krijimi i TBU në vitin 2010 kanë mundësuar akumulimin e përvojës për funksionimin e brendshëm të TBU si dhe njohjen më të mirë të mjedisit, faktorëve dhe aktorëve me ndikim në trajektoren e zhvillimit të shkollës sonë. Në veçanti, njohja më e mirë e mjedisit ekonomik e social si dhe politikat e ndryshuara të qeverisë - pritjet edhe një ligj i ri për arsimin e lartë diskutimet për të cilin kanë filluar tashmë - diktojnë nevojën e rishikimit përditësues dhe përmirësues të strategjisë së miratuar tre vite më parë.

Nga ana tjetër, meqë një pjesë e ndryshimeve të pritshme ligjore por edhe e zhvillimeve të pritshme ekonomike e sociale janë ende jo mjaftueshmërisht të qarta, strategjia e ndryshuar do të mbetet për aplikim për tre vitet e ardhshme akademike tetor 2014-shtator 2015; tetor 2015-shtator 2016 dhe tetor 2016 - shtator 2017 pa u shtyrë në horizontin e vet kohor përtej vitit 2017.

Ky dokument strategjik i ndryshuar bashkëshoqërohet edhe me planin buxhetor tre vjeçar përkatës.

## 2. ZBATIMI I DERISOTËM I STRATEGJISË

Zbatimi i strategjisë në tre vitet e para ka ecur në përgjithësi mjaft mirë nëse konsiderojmë edhe mjedisin rrethues mjaft të vështirë, konfuz e deri abuziv. Arritjet më të mëdha të kësaj periudhe janë:

- ngritja dhe plotësimi i strukturave akademike dhe organizative;
- testimi i programeve, stafeve dhe metodologjisë për të gjitha lëndet dhe vitetpërbërëse të të dy cikleve dhe të të dy fakulteteve;
- vendosja e bashkëpunimit me mjedisin e biznesit dhe institucionet publike për sigurimin e praktikave mësimore të studentëve dhe punësimin e tyre;
- plotësimi i infrastrukturës së shkollës me mjete teknike dhe teknologjike;
- kalimi me sukses i procesit të akreditimit institucional dhe për të gjitha programet;
- kalimi me sukses i disa inspektimeve ligjore e tematike nga autoritetet shtetërore;
- kryerja e një numri të madh aktivitesh bashkëpunimi me botën e biznesit, institucioneve si konkurse, konferenca, trajnime, etj;
- sigurimi i një partneri të ri të fuqishëm biznesi si ortak në TBU - Grupi Balfin;
- krijimi i një emri të mirë të TBU si shkollëkorrekte e serioze që ka për objektiv cilësinë dhe jo sasinë.

Nga ana tjetër, për vështirësi objektive dhe/ose për parashikim jo realist të tre viteve më parë, nuk janë zbatuar dhe/ose nuk ka mundësi apo rëndësi të zbatohen në tre vitet e ardhshme disa objektiva, të tilla si:

- krijimi i Fakultetit të Teknologjisë dhe Inovacionit në vitet akademike 2013-2017;
- aplikimi për akreditim në një institucion ndërkombëtar akreditimi si FIBAA ose EQUIS brenda vitit 2015;
- kërkimi shkencor aplikativ dhe shërbimet e konsulencës, ndonëse kanë nisur dhe kanë vijuar këto tre vite, nuk janë arritur nëatë niveltë lartësasi sipas kuptimit që jep strategjia fillestare (nëstrategjinë fillestare përcaktohet se do realizohet një program i gjerë kërkimesh shkencore);
- botimi i revistes tre-mujore "Tirana Business&Economy" brenda vitit 2013;
- partneritetet me një shkollë të lartë jashtë Shqipërisë brenda vitit të tretë të strategjisë;

Bazuar në arritjet dhe mosarritjet si dhe në faktorët ndikues më poshtë bëhen disa konfirmime për vijueshmërinë e strategjisë 2012-2017 dhe disa ndryshime specifike mbi këtë dokument.

### 3. VIJIMI DHE NDRYSHIMET

Për periudhën trevjeçare të ardhshme tetor 2014-shtator 2017 objektivi kryesor, ai nr. 1 i TBU do të jetë:

- **Arritja e niveleve më të larta të cilësisë së produktit të vet - studenti me dije teorike dhe aftësi praktike - të këtyra që rrisin ndjeshëm mundësitë e tij për punësim, si rregull, para mbarimit të ciklit Bachelorndërsa gjatë atij Master, studenti i punësuar arrin, si rregull, të bëjë një hap më lart në karrierë.**

Jo me kot edhe slogani i TBU është tashmë "Në TBU nuk merrni vetëm një diplomë, por nisni karrierën".

Në fakt, ky objektiv gjendet edhe në strategjinë fillestare por në njëformë ca më të përgjithshme. Theksimi i tij në këtë rishikim tëkësaj strategjie si dhe treguesit cilësorë të përfshirë në të (shprehja si rregull...), kërkojnë që objektivat strategjike në strategjinë fillestare (pika 4 e saj) dhe objektivat specifike (pika 6),ndërkohë qëvivojnë të mbesin, në tërësinë e tyre, në fuqi, duhet të rikoncepohen në funksion të objektivit nr. 1 të TBU.

Në këtë kuadër, për vitet akademike 2014-2017, marrin përparësi elementet e mëposhtëm:

#### 1. Formimi i harmonizuar teorik me aftësimin praktik

- Rritja e peshës në kredite dhe e kohëzgjatjes së praktikave profesionale (matur me ditë apo ë dhe harmonizimi i planit të praktikave gjatë viteve të studimit me spiralen e lëndëve që kryhen gjatë këtyre viteve;
- Kohëzgjatja e praktikës mund të tentojë të arrijë deri 12 muaj gjatë viteve Bachelor (shpërndarë në rritje nga viti i parë në të tretë) dhe të paktën 6 muaj nëatë Master Profesional;
- Për këtë qëllim mësimi në ciklin Bachelor për vitin e tretë e ndoshta edhe për atë të dytë duhet zhvendosur mbasdite në mënyrë që tëkrijë mundësi të gjera planifikimi dhe realizimi të praktikës mësimore përgjatë vitit (e jo vetëm në muajt e verës) me bizneset e, njëherazi, të mos ketë pengesa për punësimin e studentit ndërsa ai ende vijon studimet Bachelor me kohë të plotë;
- Në shërbim të këtij harmonizimi duhet konsideruar edhe rritja e fleksibilitetit të strukturës kurrikulare, rritja e mundësive për përzgjedhjen e lëndëve nga studenti, përdorimi më i madh i detyrave të kursit, përfshirjes në projekte të studentit, përdorimi i metodave më të personalizuara të mësimdhënies me grupe të vogla apo studentë individuale dhe e rritjes së peshës së udhëheqjes së studentit kundrejt mësimdhënies klasike në auditor;
- Programet Bachelor dhe veçanërisht ato Master Profesional duhet të pasurohen me lëndë të reja si të natyrës bazë eshtu edhe me natyrë specifike sipas profileve të përgjdhura nga studentët dhe shanseve të tyre për punësim, karrierë sipas zhvillimeve në tregun e punës si dhe për sipërmarrje vetjake;
- Një rendesi më e lartë duhet t'i jepet formimit sipërmarrës të studentëve dhe mbështetjes së nismave të tyre sipërmarrëse përmes Inkubatorit të Biznesit brenda TBU-sësi dhe përmes zgjerimit tëmbështetjes teknike e financiare nga sipërmarrje partnere të shkollës sonë.
- Ndërsa TBU formon gradualisht një skuadër në numër të arsyeshëm pedagogëshme kohë të plotë (rreth 15 gjithsej) pjesa më e madhe e volumit mësimor do të vijojë të mbështetet tek stafi akademik me kohë të pjesshme që duhet forcuar e ripërtërirëme profesionistë që kanë angazhime të përditëshme punësimi në kompani, banka dhe

sipërmarrje vetjake e, kësisoj, sjellin informacion dhe eksperiencë të drejtpërdrejtë dhe të përditësuar në mësimin në auditor. Natyrisht këto stafe me kohë të pjeshme duhet të plotësojnë kriteret përkatëse akademike për mësimdhënie, sipas cikleve Bachelor dhe Master.

## **2. Zgjerimi i numrit të bizneseve për kryerjen e praktikave profesionale, me fokus bizneset e mëdha e bankat dhe harmonizimi i metodologjisë së TBU me ato të bizneseve**

- Fokusimi tek këto biznese duhet bërë për arsye se janë të vetmet që kanë politika meritokrate në rekrutim dhe karrierën e stafeve, dhe pra kanë një koncept të ngjashëm me TBU, ndaj janë mjedisi më i përshtatshëm edhe për formimin profesional edhe për mundësinë e punësimit të studentëve të TBU;
- Administrata shtetërore dominohet nga lidhjet politike ndërsa bizneset e vogla e të mesme janë mbi baza familjare dhe në rekrutim bazohen kryesisht tek lidhjet nepotike ndaj, të dy këto kategori nuk janë mjedisi më i përshtatshëm për objektivin e TBU e duhet të mbeten dytësore në rëndësi;
- Bizneset e mëdha dhe bankat kanë metodologji dhe rregulla të vetat për praktikat profesionale të studentëve ndaj shkolla duhet t'i përshtatet bizneseve në mënyrë që të mos krijohen pengesa e burokraci të kota;
- Këto biznese të ftohen e të nxiten të sjellin stafe të tyre për shkollim Master dhe/ose Bachelor me financim të plotë ose të pjeshëm nga këto kompani. Një metodë e këtillë rrit shkallën e bashkëpunimit dhe ozmozen biznes-TBU.

## **3. Numri i kufizuar i studentëve, gjithësej 300-400 studentë aktivë dhe ekuivalent me kohë të plotë**

- Sipas frymës së strategjisë 2012-2017 dhe projeksioneve sasiore, TBU është projektuar për të qenë një shkollë me numër të kufizuar studentësh;
- TBU nisi, në tetor 2010, me 9 studentë në vitin e parë Bachelor, programi Administrim Biznesi, 6 studentë në vitin e parë Bachelor, programi E Drejta e Biznesit dhe 28 studentë në programet e ndryshme Master.
- Gjatë tre viteve të mëpasshme numri i regjistrimeve u rrit modestisht. Vetë TBU nuk ka bërë sforcë për rritje më të shpejtë pasi ka patur si metodë rritjen graduale por edhe mjedisi ka qenë turbulent dhe, ndonëse modeste, nuk janë arritur objektivat e menduar për regjistrimet.
- Eksperienca e këtyre viteve por edhe analizat më të plota mbi mjedisin ekonomik rrethues na kanë forcuar bindjen se mbajtja e një numri të kufizuar studentësh është kusht për arritjen e objektivave të cilësisë së formimit dhe punësimit të studentëve tanë.
- Tashmë kemi një përgjigje më të menduar lidhur me numrin e duhur të studentëve për regjistrim në një vit akademik. Numri i duhur i studentëve në vitin e parë Bachelor, programi Administrim Biznesi është 80-90 vetë, në atë E Drejta e Biznesit 25-35 vetë. Në programet Master 20-25 vetë për çdo program/profil por jo më shumë se 80-90 studentë gjithësej e ku regjistrohen kryesisht bacheloristë nga TBU ndërsa diferenca nga shkolla të tjera të larta.
- Duke konsideruar edhe ç'rregjistrimet edhe pezullimet e mundshme edhe zgjatjen e studimeve nga një pjesë e studentëve, me këto kufij kuotash pranimit, rezulton se numri i studentëve aktivë ekuivalent me kohë të plotë gjithësej në një vit akademik do të jetë në kufijtë 300-400 vetë.

- Këto kufij maksimalë të kuotave të pranimit, me një rritje graduale të regjistrimeve vit-pas-viti, duhet të arrihen gradualisht në vitin akademik 2016-2017 dhe të mbesin të pandryshuara (përjashto ndryshime të vogla fluktuative) për 6-8 vite pas vitit 2017.
- Me këto dimensione nga njëra anë dhe me burimet, strukturat dhe lidhjet që posedojmë dhe planifikojmë t'i zgjerojmë nga ana tjetër, garantohet cilësia e formimit teorik&praktik të studentëve dhe sigurohet një probabilitet shumë i lartë, mbi 80% e punësimit të tyre para diplomimit Bachelor.
- Me këtë numër studentësh janëmë shumë se të mjaftueshme mjediset fizike të shkollës por kërkohet një shtim i bazës kompjuterike dhe teknike.

Ndërsa elementet e mësipërme marrin rëndësi të dorës së parë, disa objektiva dhe drejtime të caktuara në strategjinë fillestare 2012-2017 që kanë lidhje të moderuar apo të dobët në arritjen e objektivit nr.1 të TBU ridimensionohen dhe ripesohen në objektiva të rëndësisë dytësore, si psh.:

- objektivi për një fakultet të tretë të Teknologjisë dhe Inovacionit shtyhet përtej vitit akademik 2016-2017.
- objektivat agresivë sasiore lidhur me botimet e revistës apo të librave ridimensionohen në nivele sasiore të moderuara.
- objektivi agresiv lidhur me kërkimin shkencor ("TBU do të përfshihet në realizimin e një programi të gjerë kërkimesh shkencore...."), ridimensionet në "mbështetje të stafit akademik për kërkim shkencor në nivel të nevojshëm"

#### 4. PLANI BUXHETOR 3 VJEÇAR DHE FINANCIMI

Sic u theksua edhe më lart, TBU do të vijojë një rritje graduale të numrit të studentëve deri në arritjen e limiteve maksimale të kuotave të regjistrimeve në vitin akademik 2016-2017 duke mbajtur të njëjtën politikë shumë favorizuese të derisotme të tarifave dhe bursave. Për rrjedhojë parashikohet që TBU të vijojë të operojë me humbje edhe për të paktën dy vite të tjera akademike: tetor 2014-shtator 2015 dhe tetor 2015-shtator 2016 me pritshmerine qe te kete nje surplus financiar ne vitin akademik tetor 2016 - shtator 2017.

Me arritjen e kuotave maksimale të parashikuara arrihet edhe mbulimi i shpenzimeve vjetore nga të ardhurat nga tarifat e studimit, përfshirë garantimin e bursave të ekselencës por edhe ato sociale si dhe fondet rezervë të domosdoshme. Bursat do të vijojnë të shprehen si zbritje në % nga tarifa bazë prej 2500 euro për çdo 60 kredite.

Njëherazi, do të vijojnë perpjekjet për të siguruar të ardhura dytësore ose sponsorizime nga biznese të ndryshme për aktivitete shtesë të shkollës si psh. konkurset me maturantët, mbështetje e nismave të biznesit të studentëve, etj.

Sipas projeksionit të numrit të pritshëm të regjistrimeve në tabelën vijuese jepet edhe buxheti në dispozicion të TBU, përfshirë masën e pritshme të financimit nga ortakët e TBU sh.p.k per vitet me humbje si dhe shpërndarjen sipas zërave kryesore, për tre vitet akademike tetor 2014-shtator 2017.

Pas fushatës masive promovionale të Shtatorit dhe Tetorit 2014, në tre vitet e ardhshme shpenzimet për promovion do të zvogëlohen ndjeshëm dhe promovioni do të bazohet gjithnjë e më shumë tek përhapja e përvojës, eksperiencave dhe arritjeve në TBU nga vetë studentët e saj dhe partnerët tanë që na njohin e na vlerësojnë. Fondet e kursyera nga promovioni do të përdoren për financimin e aktiviteteve të tjera të shkollës.

	Te ardhura dhe shpenzime ne Leke	Faktike				Plan			
		2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1	<b>Shitjet neto</b>	<b>416,310</b>	<b>12,590,561</b>	<b>17,065,445</b>	<b>9,800,192</b>	<b>16,000,000</b>	<b>24,000,000</b>	<b>46,000,000</b>	<b>54,000,000</b>
2	Kosto bruto e punës	(1,429,460)	(7,090,518)	(8,882,847)	(12,695,783)	(12,000,000)	(21,000,000)	(25,000,000)	(32,000,000)
3	Amortizimet dhe zhvlerësimet	-	(1,735,463)	(1,425,423)	(1,155,881)	(1,000,000)	(1,500,000)	(2,000,000)	(2,000,000)
4	Shpenzime të tjera	(6,890,801)	(23,386,492)	(24,350,460)	(16,734,563)	(20,000,000)	(16,000,000)	(17,000,000)	(14,000,000)
5	<b>Totali i shpenzimeve operative (2+3+4)</b>	<b>(8,320,260)</b>	<b>(32,212,473)</b>	<b>(34,658,730)</b>	<b>(30,586,227)</b>	<b>(33,000,000)</b>	<b>(38,500,000)</b>	<b>(44,000,000)</b>	<b>(48,000,000)</b>
6	<b>Fitimi/humbja nga veprimtaria kryesore (1-5)</b>	<b>(7,903,950)</b>	<b>(19,621,912)</b>	<b>(17,593,285)</b>	<b>(20,786,035)</b>	<b>(17,000,000)</b>	<b>(14,500,000)</b>	<b>2,000,000</b>	<b>6,000,000</b>
7	Te ardhura dhe/ose shpenzime financiare	105,395	200,451	(179,416)	(36,417)	(700,000)	(700,000)	(700,000)	(700,000)
8	Fitimi (humbja) para tatimit (6-7)	(7,798,556)	(19,421,461)	(17,772,701)	(20,822,452)	(17,700,000)	(15,200,000)	1,300,000	5,300,000
9	<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar</b>	<b>(7,798,556)</b>	<b>(19,421,461)</b>	<b>(17,772,701)</b>	<b>(20,822,452)</b>	<b>(17,700,000)</b>	<b>(15,200,000)</b>	<b>1,300,000</b>	<b>5,300,000</b>

**Sqarim:** Në tabelë vitet janë vite fiskale. Ndaj viti fiskal N përfaqëson vitin akademik N-1. P.sh. viti fiskal 2011 përfaqëson vitin akademik Tetor 2010 - Shtator 2011

Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin akademik Tetor 2013-Shtator 2014 rezultojnë të dobëta dhe shkalla e humbjes e lartë, mjaft e ngjashme me atë te vitit fiskal 2013. Ndaj në muajt Janar-Shtator 2014 performanca financiare e shkollës ka qenë e dobët. Por, fale rritjes se regjistrimeve në Tetor 2014 (në funksion të vitit të ri akademik Tetor 2014-Shtator 2015) parashikojmë se rezultati financiar deri më 31 Dhjetor 2014 do të jetë shumë pranë shifrave në tabelë që janë një rishikim i planit të buxhetit të miratuar një vit më parë, pra me një efekt të



ndjeshëm rritës në të ardhurat ndërkohë që për këtë vit fiskal në Shtator-Tetor janë bërë shpenzime të konsiderueshme promovionale gjithashtu.

Mbi bazën e regjistrimeve të këtij viti akademik (Tetor 2014-Shtator 2015), me një hipotezë realiste janë parashikuar në rritje regjistrimet në dy vitet e tjera akademike dhe efekti pozitiv i tyre mbi të ardhurat. Njëkohësisht janë marrë parasysh edhe rritja e shpenzimeve si efekt i rritjes së numrit të studentëve dhe orëve mësimore dhe aktiviteteve të tjera por rritja e shpenzimeve do të jetë e moderuar krahasuar me rritjen e të ardhurave.

Lidhur me regjistrimet, sic vlerësohet në strategji e ndryshuar, presim që kuotat maksimale të arrihen në vitin akademik në regjistrimet tetor 2016 (për llogari të vitit akademik tetor 2016 - shtator 2017\_ ndërsa për ciklin master kuotat maksimale të regjistrimeve të arrihen në tetor (2017 për llogari të vitit akademik tetor 2017-shtator 2018).

Mbi këto hipoteza është bërë planifikimi i buxhetit për vitet fiskale 2015, 2016, 2017 që janë buxhete të vlefshme edhe për tre vitet akademike përkatëse tetor 2014 shtator 2015; tetor 2015 - shtator 2016 dhe tetor 2016 - shtator 2017.

Sipas këtij projekcioni parashikohet që viti fiskal 2016 të jetë viti i parë me diferencë pozitive të ardhura-shpenzimeve edhe si pasojë e rritjeve të regjistrimeve në tetor 2015 por edhe si pasojë e arritjes së kuotave maksimale të regjistrimeve bachelor në tetor 2016 e që japin efekt në tre muajt e fundit të vitit fiskal 2016 dhe vijojnë të japin efekt rritës për vitin akademik tetor 2016 shtator 2017 si dhe për 9 muajt e parë të vitit fiskal 2017.

Ndërkaq, sipas hipotezës së arritjes së kuotave maksimale për ciklin master në tetor 2017, efekti në tremujorin e fundit përmirëson vitin fiskal 2017.

Përmbledhtazi: arritja e kuotave maksimale të regjistrimeve të parashikuara nga strategjia e rishikuar, pa ndryshur tarifën si dhe as vlerën dhe peshën e bursave të ekselencës apo sociale (pra as tarifën e ponderuar për cdo 60 kredite), të ardhura tejkalojnë shpenzimet dhe krijojnë mundësi për akumulimin gradual të fondeve për garanci dhe zhvillim pa patur më nevojë për subvencion nga ortakët e TBU sh.p.k.

Humbja kumulative për vitet fiskale 2010-2013 arriti në vlerën rreth 66 milion leke. Deri në fund të vitit fiskal 2014 pritet të arrijë në 83 milion lekë dhe bashkë me vitin pasardhës të arrijë në afro 100 milion lekë. Humbja e deritanishme është përbaluar vetëm nga ortakët e shoqërisë dhe do të përballohet vetëm prej tyre.

Hyrja e grupit Balfin si ortak në TBU sh.p.k. në tetor 2014 dhe angazhimi financiar prej afro 200 mijë euro që ky grup ka marrë për subvencionimin e aktiviteteve të shkollës, krahas angazhimeve të marra nga ortakët e tjerë, është garanci e plotë për vijimin dhe përfundimin e fazës së fundit të investimit në aktivitetet e shkollës deri në arritjen e aftësive vetëmbajtëse të saj.